



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0272

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi- Panel Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE Komtrejd Distribucija DOOEL, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me Licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim” me numër të prokurimit 214-26-827-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BREND SHME, më 17/06/2026, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Komtrejd Distribucija DOOEL me nr. 2026/0272 , e datës 27/04/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me Licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim”, me numër të prokurimit 214-26-827-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – MINISTRIA E PUNËVE TË BREND SHME.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - MINISTRIA E PUNËVE TË BREND SHME për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me Licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim”, me numër të prokurimit 214-26-827-1-1-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.02.2026. MINISTRIA E PUNËVE TË BREND SHME, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me Licenca te Microsoft-it per IRK dhe Edukim” me nr. të prokurimit: “214-26-827-1-1-1”

.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës 16,847,075.20 €.

Me 08.04.2026. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK (B58), kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE “Infosoft Systems SHPK: Infosoft Systems SH.P.K., Tiranë.”

Me 14.04.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 16.04.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.04.2026, OE Komtrepid Distribucija DOOEL ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0272 kundër njoftimit për dhënie të kontratës

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Komtrepid Distribucija DOOEL., janë parashtruar si në vijim:

COMPLAINT against the Decision of the Ministry of Internal Affairs dated 16.04.2026 on the Request for review Addressed to: PROCUREMENT REVIEW BODY Complainant: Komtrepid Distribucija DOOEL Skopje CONTRACTING AUTHORITY: Ministry of Internal Affairs PROCUREMENT ACTIVITY: “Supply of Microsoft Licenses for IRK and Education”

INTRODUCTION

Through this complaint, the decision of the Ministry of Internal Affairs dated 16.04.2026 is contested, by which the request for review was rejected, due to essential procedural violations, lack of substantive reasoning, failure to address decisive claims, violation of the principle of equality before the law, misinterpretation of the right to an effective legal remedy, as well as the merely formal and not substantive application of public procurement provisions, including the unjustified application of the concept of “national security”.

REASONING

The contested decision is a typical example of formal decision-making, which does not meet the minimum standard of reasoning required in public procurement procedures and administrative law in general. The contracting authority has not conducted a genuine review of the complainant’s claims, but has merely rejected them in a general and declarative manner, without providing any concrete factual or legal analysis. Such a decision constitutes an essential procedural violation, as the lack of reasoning makes it impossible to review its legality and

directly infringes upon the rights of the party.

In this context, the reference to the principle of equality before the law remains entirely formal and unsupported. The contracting authority has declared that this principle has not been violated; however, it has provided no reasoning as to how equal treatment among economic operators has been ensured. On the contrary, the circumstances themselves indicate differentiated and discriminatory treatment, as the complainant has been classified as a “risk to national security”, while other operators, under identical factual and documentary conditions, have not been subjected to such an assessment. The absence of any comparative analysis and any justification for this distinction renders this approach arbitrary and in direct contradiction with the fundamental principles of public procurement.

Particularly problematic and legally unacceptable is the unjustified use of the concept of “risk to national security”. This is a concept of extraordinary legal weight, which by its nature requires a high standard of reasoning and support by concrete and verifiable facts. However, in the challenged decision, this concept has been used merely as a formal label, without any concrete explanation, without identification of factual circumstances, and without presentation of evidence that would justify such a serious finding. Such an approach not only contradicts the principles of reasoning of administrative decisions, but also constitutes misuse of an exceptional exclusionary ground, rendering the decision fundamentally unlawful.

It is important to emphasize that the tender dossier explicitly requires the successful bidder to establish a legal entity in Kosovo and to employ local staff. In light of this, there is no reasonable basis for security concerns, particularly considering that the subject matter of the contract is limited to the supply of Microsoft licenses. Any activities performed at the end-user level will be carried out by locally employed personnel, who will, in any event, be bound by duly executed Non-Disclosure Agreements (NDAs). Furthermore, the proper execution of the contract is secured by a substantial bank guarantee (amounting to 10% of the contract value, or as otherwise specified in the tender documents). Accordingly, the reasoning provided by the first-instance authority appears to be largely unfounded and unsupported by the factual and legal circumstances of the case.

The involvement of a certified partner of Microsoft in the implementation of a public contract for Microsoft licenses does not, in itself, pose a risk to national cybersecurity. Such partnerships are a standard global practice, while the infrastructure, systems, and ultimate control remain under Microsoft and the contracting authority.

Furthermore, the decision fails to address the complainant’s claims regarding compliance with the tender dossier criteria. The complainant has argued that all requirements have been fulfilled and that in some elements it has even been more advantageous than the winning economic operator; however, these claims have not been reviewed at all. The absence of such an assessment demonstrates that the contracting authority has not exercised its discretion in a lawful and objective manner, but has instead taken a predetermined decision without analysis of the offers.

Likewise, the claim regarding the entry of the winning economic operator into a consortium in violation of procurement rules has been completely ignored. This is an essential element that directly affects the legality of the procedure, and failure to address it constitutes a serious violation of the obligation to fully examine the case.

Regarding the right to an effective legal remedy, the contracting authority has made a fundamentally incorrect interpretation by reducing this right to the mere formal existence of the possibility to submit a request for review. The complainant has not contested the existence of this remedy, but rather its effectiveness in circumstances where the initial decision lacks reasoning. Without clear reasoning, the party cannot understand the basis of the decision and cannot challenge it effectively, which means that the constitutional right has not been respected in substance, despite its formal existence.

Finally, the reference of the contracting authority to Article 19 of the Public Procurement Regulation does not find real application in this case. In order to apply this provision, it is required to identify the risk concretely, present evidence, and provide clear reasoning of the link between the facts and the legal basis. None of these elements are present in the challenged decision. Consequently, this provision has not been applied, but has merely been used as a formal reference to cover the lack of reasoning, which makes the decision even more vulnerable from the perspective of legality.

Overall, the challenged decision represents a combination of essential procedural violations and arbitrary assessment of facts, failing to meet even the minimum standards of fair decision-making in the field of public procurement. Therefore, based on the above stated facts in this complaint, we submit before the PRB the following:

PROPOSAL

I. To approve the complaint as well-founded, to annul the decision of the Ministry of Internal Affairs dated 16.04.2026, as well as the decision on the award of the winning economic operator, and to order a full and lawful re-evaluation of the procurement procedure; or subsidiarily

II. To annul the challenged decision and remand the case for reconsideration to the contracting authority, with the obligation to issue a reasoned decision based on facts and in compliance with the principles of public procurement.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimit të Kërkesës për rishqyrtim e ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore dhe konstaton se:

-Sa i përket pretendimit të Operatorit Ekonomik për shkelje të Nenit 24 të Kushtetutës (Barazia para ligjit), Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim të pabazuar dhe të paargumentuar. Procesi i prokurimit është zhvilluar në përputhje të plotë me parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën. Të gjithë operatorët ekonomikë janë trajtuar mbi bazën e të njëjtave kritere dhe kërkesa të përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit. Eliminimi i Operatorit Ekonomik nuk është bërë në mënyrë arbitrare apo diskriminuese, por si rezultat i një vlerësimi objektiv të përmbushjes së kërkesave, veçanërisht atyre që ndërlidhen me sigurinë kibernetike dhe ofrimin e shërbimeve në institucione publike.

-Sa i përket pretendimit për shkelje të Nenit 32 të Kushtetutës (E drejta për mjete efektive juridike), Autoriteti Kontraktues-ZPP thekson se vendimi për eliminim përmban arsyetim të mjaftueshëm, të qartë dhe të bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, konkretisht në Nenin 19 të Rregullores për Prokurim Publik. Vendimi i AK-MPB identifikon bazën ligjore të eliminimit dhe

shpjegon rrezikun e identifikuar në kontekstin e sigurisë dhe qasjes në institucione publike. Kjo i ka mundësuar Operatorit Ekonomik të kuptojë në mënyrë të plotë arsyet e eliminimit dhe të ushtrijë në mënyrë efektive të drejtën e tij për ankesë, gjë që dëshmohet edhe nga vetë paraqitja e kësaj kërkesë për rishqyrtim. Prandaj, pretendimi për mungesë të mjeteve efektive juridike është kontradiktor në vetvete dhe nuk qëndron, pasi mekanizmat ligjorë janë respektuar dhe janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk ka asnjë shkelje të Nenit 24 dhe Nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Eliminimi i Operatorit Ekonomik është bërë në përputhje të plotë me dispozitat e Nenit 19 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 002/2024, përkatësisht paragrafët 19.7, 19.8 dhe 19.9, të cilat lejojnë përjashtimin e operatorëve ekonomikë në rastet kur ekzistojnë rreziqe të arsyeshme që ndërlidhen me sigurinë, integritetin, besueshmërinë dhe mbrojtjen e interesit publik.

Në dosjen e tenderit është kërkuar jo vetëm furnizimi me licenca, por edhe ofrimi i shërbimeve të përkrahjes teknike për produktet dhe zgjidhjet e Microsoft, nga ekspertë të licencuar, me çmim për orë pune. Kjo kërkesë e zgjeron në mënyrë substanciale natyrën e kontratës nga furnizim në ofrim të drejtpërdrejtë të shërbimeve brenda institucioneve publike. Si rezultat, operatori ekonomik i përzgjedhur do të ketë qasje në sisteme informative shtetërore dhe platforma operative, ndërveprim me të dhëna potencialisht sensitive dhe konfidenciale, prezencë dhe aktivitet në institucione që mund të klasifikohen si infrastrukturë kritike shtetërore.

Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të zbatojë standarde të rritura të kujdesit në përputhje me legjislacionin për siguri kibernetike dhe mbrojtjen e sistemeve të informacionit në Republikën e Kosovës. Bazuar në këtë, gjatë procesit të vlerësimit komisioni me të drejtë ka vendosur në eliminimin e ofertës tuaj dhe ka konstatuar se Operatori Ekonomik nuk garanton menaxhim të sigurt të qasjes në sistemet shtetërore dhe nuk përmbush standardet e nevojshme të sigurisë për operim në mjedise institucionale me ndjeshmëri të lartë sipas rregullativës ligjore për mbrojtje dhe siguri të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Në përputhje me Nenin 19.7 dhe 19.9, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përjashtojë një operator ekonomik kur ekziston një rrezik i arsyeshëm për sigurinë kombëtare, sigurinë e informacionit apo funksionimin e institucioneve publike, edhe në mungesë të një shkeljeje të provuar, por mbi bazën e vlerësimit të rrezikut. Pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim nuk adresojnë në mënyrë substanciale këtë dimension të kontratës dhe nuk ofrojnë prova të reja që do të eliminonin këto rreziqe të identifikuara. Për rrjedhojë, ato mbeten deklarative dhe të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin.

Sa i përket pretendimeve për trajtim të pabarabartë dhe mungesë transparence, Autoriteti Kontraktues thekson se kriteret janë vendosur paraprakisht në dosjen e tenderit, të gjithë operatorët ekonomikë janë vlerësuar mbi baza të njëjta dhe vendimi është marrë mbi bazën e një vlerësimi profesional dhe proporcional të rrezikut. Gjithashtu në dosjen e tenderit të Aneksi 1 është dhënë informata se gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe përzgjedhjes së kontraktuesit, Autoriteti Kontraktues do të marrë parasysh paragrafët 19.7 - 19.8 dhe 19.9 të nenit 19 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 002/2024. Autoriteti Kontraktues ka obligim ligjor dhe institucional të mbrojë interesin publik, sigurinë e sistemeve shtetërore dhe integritetin e të dhënave, veçanërisht kur kontrata përfshin qasje në infrastrukturë kritike dhe shërbime operative brenda institucioneve.

Në mungesë të provave bindëse nga Operatori Ekonomik që do të garantonin eliminimin e këtyre rreziqeve, vendimi për eliminim është i drejtë, proporcional dhe në përputhje të plotë me

legjislacionin në fuqi. Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimi të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore; të gjitha janë të cekura më lart.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 29.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0272, ndërsa me datë 06.05.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0272, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të neni 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Komtrejd Distribucija DOOEL., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0272 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues profesional në pretendimet ankimore të OE ankues

Eksperti shqyrtues profesional, pas pranimi të autorizimit për shqyrtimin e ankesës dhe pretendimeve ankimore të OE ankues, ka shkarkuar dhe analizuar dosjen e tenderit së bashku me dokumentacionin përcjellës, si dhe dosjet e dorëzuara nga OE konkurrues dhe të gjitha njoftimet dhe vendimet lidhur me këtë aktivitet të prokurimit publik.

Në cilësinë e ekspertit shqyrtues, duke marrë parasysh përgjegjësitë që rrjedhin nga LPP, kam shqyrtuar në detaje Dosjen e Tenderit, Aneksin 1, sqarimet e dhëna gjatë procedurës, Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, kërkesën për rishqyrtim, përgjigjen e AK-së në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën e OE ankues drejtuar OSHP-së, dhe në vijim i paraqes sqarimet dhe rekomandimet e mia profesionale për Panelin Shqyrtues të OSHP-së, duke u fokusuar në pretendimet ankimore të OE ankues, në arsyetimin e Autoritetit Kontraktues dhe në dokumentacionin mbi të cilin është zhvilluar dhe udhëhequr kjo procedurë e prokurimit publik.

Eksperti shqyrtues sqaron për Panelin Shqyrtues të OSHP-së se AK, me anë të këtij aktiviteti të prokurimit, kërkon të lidhë kontratë kornizë me një OE ose Grup të OE-ve, për t'u furnizuar me licenca dhe produkte të Microsoft-it për institucione publike dhe për edukim, duke përfshirë Microsoft 365, Office, Windows Enterprise, Core CAL, Exchange, SharePoint, SQL Server,

Windows Server, System Center, Azure DevOps, Teams, Copilot dhe produkte të tjera të ngjashme, për institucionet e Republikës së Kosovës dhe për edukim.

Këto licenca përdoren për komunikim institucional, menaxhim të përdoruesve, emaila, serverë, baza të të dhënave, sisteme operative, bashkëpunim digjital dhe funksionim të përgjithshëm të infrastrukturës IT të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Përveç furnizimit me licenca, Aneksi 1 parasheh edhe përkrahje teknike për produktet dhe zgjidhjet e Microsoft-it, sipas nevojave të institucioneve, nga ekspertë të licencuar nga Microsoft, me 300 orë për një vit dhe 900 orë për tri vite. Pra, nuk kemi të bëjmë vetëm me blerje licencash, por edhe me përkrahje teknike në sisteme shtetërore.

Duke pasur parasysh natyrën e produkteve dhe shërbimeve të kërkuara, ky aktivitet lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e sistemeve informative të institucioneve publike, ku përfshihen të dhëna zyrtare, komunikime institucionale dhe sisteme me rëndësi operative. Prandaj, vlerësimi i ofertave nuk mund të kufizohet vetëm në çmim, por duhet të marrë parasysh edhe përputhshmërinë me dosjen, besueshmërinë e operatorit ekonomik dhe aspektet që lidhen me sigurinë dhe interesin publik.

Sipas procesverbalit të hapjes të datës 16.03.2026, për këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar dy oferta:

GOE Infosoft Systems SHPK; Infosoft Systems SH.P.K., Tiranë, vlera totale e ofertës: 16,769,481.84 EUR.

Komtrejd Distribucija DOOEL Skopje, vlera totale e ofertës: 16,747,658.61 EUR.

Nga këtu vërejmë një dallim në mes të ofertave prej 21,823.23 EUR, pra oferta e GOE të propozuar për t'u shpërblyer me kontratë është më e lartë. Por, edhe pse në këtë aktivitet kriter për dhënie është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ky kriter merret parasysh vetëm nëse oferta është e përgjegjshme dhe nuk ekzistojnë arsye ligjore, administrative apo teknike që e bëjnë atë të papranueshme për AK-në.

Duhet të ceket se, gjatë udhëheqjes së kësaj procedure të prokurimit publik, AK ka vepruar në çdo fazë të saj në përputhje me LPP-në, duke publikuar sqarimet, përgjigjet në kërkesat për sqarime dhe atë për rishqyrtim, si dhe duke e pezulluar aktivitetin në dy raste, të gjitha në pajtim me LPP-në, brenda afateve të parapara ligjore dhe duke i trajtuar të gjitha palët e interesit pa diskriminim dhe si të barabarta.

OE ankues, në ankesën e paraqitur pranë OSHP-së, pretendon se vendimi i AK-së është formal, i paarsyetuar, se nuk janë trajtuar pretendimet vendimtare, se është cenuar barazia ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe se është përdorur në mënyrë të paarsyetuar koncepti i “rrezikut për sigurinë kombëtare”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, vlerësoj se këto pretendime nuk mund të pranohen të izoluara nga natyra reale e kontratës, pasi që ky aktivitet nuk ka të bëjë vetëm me blerje të thjeshtë të licencave, por përfshin furnizim me produkte Microsoft për institucione publike dhe edukim, si dhe përkrahje teknike për produktet dhe zgjidhjet Microsoft nga ekspertë të licencuar, sipas nevojave të institucioneve. Në Aneksin 1 është paraparë shprehimisht edhe pozicioni për përkrahje teknike, me 300 orë për një vit dhe 900 orë për tri vite.

Në këtë kuptim, pretendimi i OE ankues se kemi të bëjmë vetëm me licenca softuerike nuk e pasqyron objektin e kontratës. Përkrahja teknike, varësisht nga nevojat e institucioneve, mund të lidhet me konfigurim, asistencë, ndërhyrje teknike dhe, çka është më e rëndësishmja, qasje në ambiente institucionale për trajtim të sistemeve që përdoren nga autoritetet shtetërore të Kosovës. Prandaj, vlerësimi i AK-së mbi besueshmërinë, sigurinë, kontrollin dhe rrezikun e mundshëm nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohet i panevojshëm ose jashtë objektit të prokurimit.

Në njoftimin mbi vendimin e AK-së, OE ankues është njoftuar se është eliminuar për shkak të papranueshmërisë administrative dhe për arsye që lidhen me sigurinë e sistemeve dhe rrjeteve informative, mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme dhe konfidenciale, integritetin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik, strukturën e pronësisë dhe kontrollit, përfshirjen e palëve të treta në përkrahjen teknike për produktet Microsoft dhe mundësinë e qasjes në sisteme me rëndësi vitale shtetërore.

Nga dokumentet e shqyrtuara, vërehet se AK ka dhënë arsyetim lidhur me natyrën e kontratës, përfshirjen e përkrahjes teknike, qasjen potenciale në sisteme institucionale, mbrojtjen e të dhënave dhe rrezikun e arsyeshëm për sigurinë e sistemeve publike. Ky arsyetim mund të mos jetë i zgjeruar në çdo detaj teknik, mirëpo është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me përgjegjësinë e AK-së për të parandaluar rrezikun para se ai të materializohet. Për këtë arsye, pretendimi se vendimi është tërësisht formal nuk qëndron dhe është i pabazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues ka të bëjë me përdorimin e konceptit të “sigurisë kombëtare”. Ky pretendim duhet të trajtohet me kujdes, sepse nuk kërkohet domosdoshmërisht që AK të provojë një dëm të ndodhur apo incident konkret paraprak. Në kontrata që prekin sisteme informative, të dhëna institucionale dhe shërbime teknike, vlerësimi bëhet mbi bazën e rrezikut të arsyeshëm dhe potencialit të ndikimit në sigurinë, integritetin dhe funksionimin e institucioneve. Për këtë arsye, vendimi i AK-së për të marrë në konsideratë aspektet e sigurisë nuk mund të konsiderohet i paligjshëm vetëm pse ankuesi nuk pajtohet me peshën që AK i ka dhënë këtij rreziku.

Sa i përket pretendimit ankimor se AK nuk ka trajtuar pretendimin për operatorin ekonomik fitues dhe pjesëmarrjen e tij në grup, nga dokumentet e këtij aktiviteti rezulton se AK ka kërkuar sqarime nga GOE i propozuar për shpërbllim me kontratë lidhur me çështje të caktuara të ofertës, përfshirë indeksin/kursin USD-EUR sipas BQK-së dhe çështjen e faturimit nga anëtarët e grupit. Kërkesat për sqarim të datave 30.03.2026 dhe 31.03.2026 tregojnë se AK ka ndërmarrë veprime për verifikim dhe sqarim gjatë vlerësimit, pra në asnjë moment nuk ka vepruar në mënyrë pasive apo të paracaktuar.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore, vëmendja ime si ekspert shqyrtues është tërhequr veçanërisht nga fakti se AK, në arsyetimin e tij, i është referuar paragrafëve 19.7, 19.8 dhe 19.9 të nenit 19 të Rregullores për Prokurim Publik, që lidhen me specifikimet teknike, sigurinë kibernetike, produktet digjitale, furnizuesit, nënfurnizuesit dhe burimet e mundshme të rrezikut në kontrata që prekin teknologjinë informative. Ky referim nuk më është dukur i rastësishëm dhe, për këtë arsye, kam konsideruar të nevojshme që, përveç analizimit të dokumentacionit të tenderit dhe pretendimeve ankimore, të bëj edhe një verifikim të burimeve publike lidhur me profilin dhe strukturën e OE ankues.

Nga faqja zyrtare e Comtrade Distribution DOO rezulton se OE ankues Komtrejd Distribucija DOOEL Skopje është njësia e Comtrade Distribution DOO për Maqedoninë e Veriut, me adresë

Kiro Gligorov Boulevard 13, 1000 Skopje. Në të njëjtën faqe figuron edhe Comtrade Distribution d.o.o. Beograd, me adresë Bulevar Zorana Đindica 125i, 11000 Belgrade, si pjesë e të njëjtit rrjet: <https://www.comtradedistribution.com/contact/>.

Në nivel grupi, faqja zyrtare e Comtrade e paraqet Veselin Jevrosimovic nga Beogradi si Founder & President of Comtrade Group, ndërsa faqja zyrtare e Comtrade Distribution e paraqet atë si Chairman of the Board – Comtrade Group dhe si Owner and Chairman of the Board of Comtrade Group: <https://www.comtrade.com/leadership/veselin-jevrosimovic/>.

Pra, Comtrade Group – Serbia është pronare e njërive, kurse Veselin Jevrosimovic është pronar i grupacionit të ndërmarrjeve.

Kjo informatë lidhet drejtpërdrejt me qëndrimin e AK-së në vendimin për dhënie dhe në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, ku AK është thirrur në rrezikun për sigurinë e sistemeve, rrjeteve informatike, të dhënave sensitive, strukturën e pronësisë dhe kontrollit, si dhe përfshirjen eventuale të palëve të treta në përkrahjen teknike për produktet Microsoft. Andaj, duke i marrë parasysh këto si më lart, referimi i AK-së në paragrafët 19.7, 19.8 dhe 19.9 të Rregullores për Prokurim Publik nuk mund të trajtohet aspak si formulim formal apo i rastësishëm. Përkundrazi, ai lidhet me detyrimin e AK-së që, në prokurimet që prekin teknologjinë informative, produktet digjitale, softuerin, shërbimet, furnizuesit dhe nënfurnizuesit, të marrë parasysh sigurinë kibernetike, burimin e furnizimit, strukturën e kontrollit dhe rrezikun potencial për institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Në përfundim, nga këndvështrimi profesional, hulumtimi mbi profilin dhe strukturën pronësore të OE ankues e forcon arsyetimin e AK-së se, në këtë procedurë, nuk ka qenë e mjaftueshme të shikohet vetëm çmimi më i ulët. AK ka pasur bazë të arsyeshme të vlerësojë edhe besueshmërinë, kontrollin, strukturën, zinxhirin e furnizimit dhe rrezikun potencial që lidhet me realizimin e kontratës.

Në rastin konkret, objekti i prokurimit lidhet me sisteme dhe produkte që përdoren nga institucionet publike, ndërsa komponenta e përkrahjes teknike krijon mundësi reale që operatori ekonomik ose personat e angazhuar prej tij të kenë rol teknik në ambiente institucionale. Prandaj, vlerësimi i AK-së për rrezikun nuk është abstrakt, por lidhet me natyrën e kontratës dhe me detyrimin e AK-së për të mbrojtur interesin publik, sigurinë e sistemeve dhe të dhënat institucionale.

Si përfundim i kësaj ekspertize, eksperti shqyrtues konstaton se, edhe pse oferta e OE ankues ka qenë me çmim më të ulët, AK ka pasur të drejtë dhe detyrim që, përveç çmimit, të vlerësojë edhe natyrën e kontratës, përfshirjen e përkrahjes teknike, qasjen potenciale në sisteme institucionale, mbrojtjen e të dhënave, besueshmërinë e operatorit ekonomik dhe rrezikun e arsyeshëm për interesin publik.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues në këtë procedurë i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pa bazuara.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi B58 "Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues"- MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me Licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim", me numër të prokurimit 214-26-827-1-1-1, nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Poashtu Paneli Shqyrtues vlerëson sikurse parashihet në nenin 24 citoj 2. Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" si dhe neni 59 citoj 1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyësor lidhur me këtë çështje".

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - Komtrejd Distribucija DOOEL**
- Arkivës së OSHP-së: